

Kapitulli 12

Tatimet

Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, ju do të keni mundësi të:

- Diskutoni dhe zbatoni njohjen dhe matjen e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra
- Diskutoni dhe zbatoni njohjen e tatimit të shtyrë dhe aktual si e ardhur ose shpenzim
- Diskutoni dhe zbatoni trajtimin e tatimit të shtyrë në një kombinim biznesesh.




E drejta e autorit dhe Përkthimi

Materiali Paper P2, Corporate Reporting (CR), ACCA, i publikuar nga KAPLAN në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) dhe përdoret me lejen e KAPLAN. KAPLAN nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të KAPLAN është teksti që KAPLAN ka publikuar në gjuhën angleze.

Përkthyer në Shqip në pajtim me politikën e përkthimit të KAPLAN nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Një nga objektivat e performancës PER **practical experience requirement** (PO6) është të regjistrojë dhe përpunojë transaksionet dhe ngjarjet. Ju duhet të përdorni trajtimin e duhur kontabël për transaksionet dhe ngjarjet. Këto duhet të jenë historike dhe të ardhshme- dhe duhet të përfshijnë transaksionet jo-rutinë. Të punuarit me këtë kapitull do t'ju ndihmojë ju të kuptoni si t'i paraqesni këto objektiva.



1. Parimet bazë të tatimit

Tatimi

Tatimi është një shpenzim i madh për njësitë e biznesit. Sipas SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat, ka dy elementë për tu taksuar me të cilat një entitet duhet të merret:

- **Tatimi aktual** - shuma e pagueshme te organet tatimore në lidhje me aktivitetet tregtare të periudhës aktuale.
- **Tatimi i shtyrë** - një matje kontabël e përdorur për të përputhur efektet tatimore të transaksioneve me trajtimin e tyre kontabël. Nuk është një tatim që vendoset nga qeveria dhe që duhet të paguhet, por është thjesht një aplikim i konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Si përmbledhje, shpenzimi tatimor për një entitet llogaritet si më poshtë:

Shpenzimi tatimor = tatimi aktual +/- ndryshimet në tatimin e shtyrë

2. Tatimi aktual

Kontabilizimi për tatimin aktual

Tatimi aktual është shuma e pritur për tu paguar te organet tatimore duke aplikuar legjislacionin tatimor dhe normat e tatimeve të vendosura në datën e raportimit.

Tatimi aktual njihet në pasqyrat financiare nëpërmjet regjistrimit të mëposhtëm:

Debi: Shpenzime tatimore (PASH)

Kredi: Tatimi i pagueshëm (Pasqyra e pozicionit financiar)

Kontabiliteti i tatimit aktual bazohet në vlerësime dhe shuma e pagueshme në fund është shpesh e papërfunduar derisa pasqyrat financiare të jenë autorizuar për publikim:

- Nëse shuma e mundshme e paguar është më e vogël sesa vlerësimi i njohur në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, atëherë kjo do të zvogëlojë shpenzimet tatimore aktuale në periudhën e ardhshme kontabël
- Nëse shuma e mundshme e paguar është më e madhe sesa vlerësimi i njohur në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, atëherë kjo do të zvogëlojë shpenzimet tatimore aktuale në periudhën e ardhshme kontabël.

3. Parimet bazë të tatimit të shtyrë

Nevoja për të parashikuar tatimin e shtyrë

Në përgjithësi ka dallime midis standardeve të kontabilitetit (siç janë SNRF) dhe rregullave tatimore të një juridiksioni të veçantë. Kjo do të thotë që fitimet kontabël normalisht janë të ndryshme nga fitimet e tatueshme.

Disa ndryshime midis trajtimeve tatimore dhe kontabël janë të përhershme:

- Gjobat, donacionet politike dhe kostot **stafit** do të vendosen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, por normalisht nuk lejohen nga organet tatimore. Prandaj, këto kosto eliminohen ('shtohen përsëri') në llogaritjen e tatimit të kompanisë.

Disa ndryshime midis trajtimeve tatimore dhe kontabël janë të përkohshme:

- Aktivet kapitale mund të regjistrohen me norma të ndryshme për qëllime tatimore prandaj ato janë në pasqyrat financiare.

Diferencat e përkohshme mund të nënkuptojnë që fitimet raportohen në pasqyrat financiare përpara se ato të taten. Përndryshe, kjo mund të nënkuptojë që tatimi është i pagueshëm edhe pse fitimet nuk janë raportuar akoma në pasqyrat financiare.

Sipas konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, efekti tatimor i një transaksioni duhet të raportohet në të njëjtën periudhë kontabël si transaksioni në vetvete. Prandaj, mund të kërkohet një rregullim i ngarkesës tatimore. Kjo krijon një tatim të shtyrë.

Tatimi i shtyrë lind vetëm në diferencat e përkohshme. Nuk llogaritet për ndryshimet e përhershme.

Një **diferencë e përkohshme** është një diferencë midis vlerës kontabël të një aktivi ose detyrimi dhe bazës së tij tatimore.

Baza tatimore është "shuma që i atribuohet një aktivi ose detyrimi për qëllime tatimore" (SNK 12, paragrafi 5).

Shembull 1 - Parimet bazë të tatimit të shtyrë

Prudent përgatit pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor të çdo viti. Më 1 Janar 20X0, entiteti bleu një aktiv afatgjatë për 1.6 milion \$ që kishte një jetë të dobishme të parashikuar katër vite. Ky aktiv është përcaktuar për lehtësim tatimor të menjëhershëm prej 100% të kostos së aktivit.

Llogaritjet paraprake, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20X0, treguan një fitim para tatimit prej 2 milion \$. Drejtorët presin që ky nivel fitimi të mbahet për të ardhmen e parashikuar.

Prudent e paguan tatimin me një normë prej 30%. Pavarësisht diferencave të shkaktuara nga blerja e aktivit afatgjatë në 20X0, nuk ka ndryshime të tjera midis fitimit kontabël dhe fitimit të tatueshëm ose bazës tatimore dhe vlerës kontabël të aktiveve neto.

Kërkohe:

Llogaritni fitimet para dhe pas tatimit të Prudent për secilin nga katër vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 20X0-20X3 dhe për periudhën në tërësi duke supozuar se:

(a) tatimi i shtyrë nuk njihet

(b) tatimi i shtyrë njihet.

Zgjidhje

a) Nuk ka tatim të shtyrë

Fillimisht është e nevojshme të llogaritet fitimi i tatueshëm i Prudent për secilën periudhë dhe tatimi i pagueshëm aktual:

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor				Totali 000\$
	20X0 000 \$	20X1 000\$	20X2 000\$	20X3 000\$	
Fitimi kontabël	2,000	2,000	2,000	2,000	8,000
Plus zhvlerësimi	400	400	400	400	1,600
Reduktimi i zbritjeve kapitale	(1,600)	-	-	-	(1,600)

	800	2,400	2,400	2,400	8,000
Fitimi i tatueshëm	240	720	720	720	2,400
Tatimi aktual prej 30%					

Diferenca midis fitimit kontabël dhe fitimit të tatueshëm që ndodh nga një vit në tjetrin, anulohet gjatë katër viteve si një e tërë.

Pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve për secilën periudhë dhe për të katërta vitet si një e tërë, jepen më poshtë:

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor				Totali
	20X0 000 \$	20X1 000\$	20X2 000\$	20X3 000\$	000\$
Fitimi përpara tatimit	2,000	2,000	2,000	2,000	8,000
Tatimi aktual	(240)	(720)	(720)	(720)	(2,400)
Fitimi pas tatimit	1,760	1,280	1,280	1,280	5,600

Është paraqitur një profil më i rëndësishëm performance.

Shembuj të diferencave të përkohshme

Diferencat e përkohshme përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm në):

- Zbritjet tatimore për koston e aktiveve afatgjata që kanë një model të ndryshëm të pakësimit të aktivitetit në pasqyrat financiare.
- Fitimet brenda grupit në inventar që janë të parealizuar për qëllime konsolidimi, por të tatueshme për llogaritjen e entitetit të grupit që ka kryer fitimin e parealizuar.
- Humbjet e raportuara në pasqyrat financiare, por lehtësimi tatimor i lidhur është në dispozicion vetëm nëpërmjet mbartjes përkundrejt fitimeve të tatueshme në të ardhmen.
- Aktivitetet rivlerësohen në rritje në pasqyrat financiare, por asnjë rregullim nuk bëhet për qëllime tatimore.
- Kostot e zhvillimit kapitalizohen dhe amortizohen në fitim ose humbje për periudhat e ardhshme, por zbriten për qëllime tatimore siç ndodhin.
- Kostoja e dhënies së opsioneve të aksioneve punonjësve njihet në fitim ose humbje, por asnjë zbritje tatimore nuk mbahet derisa të ushtrohen opsionet.

Llogaritja e diferencave të përkohshme

Tatimi i shtyrë llogaritet duke krahasuar vlerën kontabël të një aktivi ose detyrimi me bazën e tij tatimore. Baza tatimore është shuma që i atribuohet aktivitetit ose detyrimit për qëllime tatimore. Për të ndihmuar në përcaktimin e bazës tatimore, SNK 12 vëren se:

- “Baza tatimore e një aktivi është shuma e zbritshme për qëllime tatimore kundrejt çdo përfitimi ekonomik të tatueshëm që do të rrjedhë tek entiteti kur ai rikuperon vlerën kontabël të aktivitetit. Në qoftë se këto përfitime ekonomike nuk do të jenë të tatueshme, baza tatimore e aktivitetit është e barabartë me vlerën e tij kontabël neto ” (SNK 12, paragrafi 7).
- “Baza tatimore e një detyrimi është vlera e tij kontabël, minus çdo shumë që do të jetë e zbritshme për qëllime tatimore në lidhje me këtë detyrim në periudhat e ardhshme. Në rastin e një të ardhure që është marrë paradhënie, baza tatimore e detyrimit që rezulton është vlera e tij kontabël, minus çdo shumë të ardhurash që nuk do të jetë e tatueshme në periudhat e ardhshme” (SNK 12, paragrafi 8).

Kur shikoni ndryshimin midis vlerës kontabël dhe bazës tatimore të një aktivi ose detyrimi dallojmë se:

- Nëse vlera kontabël tejkalon bazën tatimore, diferenca e përkohshme thuhet se është një diferencë e përkohshme e **tatueshme**, e cila do të krijojë një **detyrim** tatimor të shtyrë.
- Nëse baza tatimore tejkalon vlerën kontabël, diferenca e përkohshme është një diferencë e përkohshme e **zbritshme**, e cila do të krijojë një **aktiv** tatimor të shtyrë.

Testoni njohuritë tuaja 1 – Dive (diferencat e përkohshme)

Një entitet, Dive, jep informacionin e mëposhtëm në lidhje me aktivet dhe detyrimet e saj më 31 dhjetor 20X1.

	Vlera kontabël	Baza tatimore	Diferencat e përkohshme
Aktivet			
Një makinë kushton 100,000\$. Deri më tani është ngarkuar zhvlerësimi prej 18,000\$. Gjithashtu është deklaruar zbritja tatimore prej 30,000 \$.			

Interesi i arkëtueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar është 1,000\$. Interesi do të tatohet kur të arkëtohet.			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare kanë një vlerë kontabël prej 10,000 \$. E ardhura është përfshirë në fitimin e tatueshëm.			
Inventari ka qenë regjistruar në pasqyrat financiare nga 500 \$ në 4,500 \$. Reduktimi injorohet për qëllime tatimore derisa inventari të shitet.			
Detyrimet			
Detyrimet aktuale përfshijnë shpenzimet e konstatuara prej 1,000 \$. Kjo është e zbritshme nga tatimet në bazë të mjeteve monetare të paguara.			
Shpenzimet e konstatuara kanë një vlerë kontabël prej 5,000\$. Shpenzimi i lidhur është zbritur për qëllime tatimore.			

Kërkohet:**Plotësoni tabelën me vlerën kontabël, bazën tatimore dhe diferencën e përkohshme për secilën nga aktivet dhe detyrimet.**

4. Detyrimet tatimore dhe aktivet e shtyra

Njohja

Sipas SNK 12 *Tatimi mbi të Ardhurat*, tatimi i shtyrë duhet të parashikohet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, përveç nëse detyrimi tatimor i shtyrë rrjedh nga:

- emri i mirë, për të cilin amortizimi nuk është i zbritshëm nga tatimi
- njohja fillestare e një zëri që nuk ndikon as fitimin kontabël, as fitimin e tatueshëm dhe që nuk rezulton nga një kombinim biznesi.

Aktivitet tatimore të shtyra duhet të njihen me të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, përveç nëse:

- zbatohen përjashtimet e mësipërme
- fitimet e tatueshme të pamjaftueshme pritet të jenë të disponueshme në të ardhmen kundrejt të cilave mund të përdoret diferenca e përkohshme e zbritshme.

Matja

Norma e tatimit në fuqi (ose pritet të jetë në fuqi) kur aktivi është realizuar ose detyrimi është shlyer, duhet të aplikohet në diferencën e përkohshme për të llogaritur tepricën e tatimit të shtyrë. SNK 12 specifikon që kjo normë duhet të bazohet në legjislacionin e miratuar ose që do të miratohet në datën e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra **nuk** zbriten në vlerën aktuale.

Regjistrimi në fitim ose humbje dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me tatimin e shtyrë është ndryshimi midis detyrimit (ose aktivitet) në fillim të vitit dhe detyrimit (ose aktivitet) në fund të vitit. Është e rëndësishme të theksohet se:

- Nëse zëri që krijon tatimin e shtyrë trajtohet në fitim ose humbje, tatimi i shtyrë i lidhur duhet të paraqitet gjithashtu në fitim ose humbje.
- Nëse zëri që krijon tatimin e shtyrë trajtohet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, tatimi i shtyrë i lidhur me të duhet të regjistrohet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të mbahet brenda kapitalit neto.

Paraqitja

Detyrimet dhe aktivitet tatimore të shtyra paraqiten si afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar.

SNK 12 vëren se aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra mund të kompensohen për sa kohë që:

- entiteti ka një të drejtë detyruese ligjore për të shlyer aktivitet dhe detyrimet tatimore **aktuale**

- aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra lidhen me tatimin e vendosur nga i njëjti organ tatimor.

Testoni njohuritë tuaja 2 – Dive (llogaritja e tatimit të shtyrë)

Kërkohet:

Duke përdorur informacionin e 'testoni njohuritë tuaja 1', llogaritni tepricën e tatimit të shtyrë të Dive më 31 dhjetor 20X1. Norma e aplikueshme e tatimit është 30%.

Testoni njohuritë tuaja 3 - Brick

Brick është një kompani, që ka si datë raportimi 30 Prillin 20X4. Kompania ka një lehtësim tatimor për shpenzimet e kërkim-zhvillimit mbi bazën e mjeteve monetare të paguara. Njohja e një aktivi për **zhvillimin material** gjatë këtij viti, në përputhje me SNK 38, krijoi një diferencë të perkohshme të tatueshme e të rëndësishme si në 30 Prill 20X4.

Norma e tatimit për kompanitë në datën e raportimit ishte 22%. Më 6 qershor 20X4, qeveria miratoi legjislacionin për të ulur normën e tatimit të kompanisë në 20% nga 1 janari 20X5.

Kërkohet:

Shpjegoni se cila normë tatimore duhet të përdoret për të llogaritur detyrimin tatimor të shtyrë që do të përfshihet në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 30 Prill 20X4.

5. Situatat specifike

Rivlerësimet

Tatimi i shtyrë duhet të njihet në rivlerësimin e tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve edhe nëse:

- entiteti nuk ka qëllim ta shesë aktivin
- çdo tatim për shkak të fitimit të marrë nga çdo shitje e aktivit mund të shtyhet duke u 'mbështetur' në koston e një aktivi zëvendësues.

Fitimet e rivlerësimit regjistrohen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe kështu që çdo tatim i shtyrë që rrjedh nga rivlerësimi duhet të regjistrohet edhe në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Testoni njohuritë tuaja 4 - Dodge

Një entitet, Dodge, zotëron tokë, ndërtesë, makineri dhe pajisje që kushtojnë \$ 100,000 kur blihen. Zhvlerësimi prej 40,000 \$ deri në datën e raportimit është ngarkuar më 31 Mars 20X1. Entiteti ka zbritje tatimore totale për aktivin në masën 50,000 \$. Më 31 Mars 20X1, aktivi rivlerësohet në 90,000 \$. Norma e tatimit është 30%.

Kërkohet:

Shpjegoni implikimet e tatimit të shtyrë për këtë situatë.

Skemat e opsionit të aksionit

Kontabiliteti për skemat e opsioneve të aksioneve përfshin njohjen e një shpenzimi vjetor shpërblimi në fitim ose humbje përgjatë gjithë periudhës së kushtëzimit. Lehtësimi tatimor normalisht nuk jepet derisa të ushtrohen opsionet e aksioneve. Shuma e lehtësimit tatimor të dhënë bazohet në vlerën e brendshme të opsioneve (diferenca midis çmimit të tregut të aksioneve dhe çmimit të ushtrimit të opsionit).

Ky lehtësim tatimor i vonuar nënkupton që skemat e pagesave të bazuara në aksione të shlyera në kapital krijojnë një aktiv tatimor të shtyrë.

Pasqyra burime-përdorime e mëposhtme mund të përdoret për të llogaritur aktivin tatimor të shtyrë që lind në nga një skemë pagese të bazuar në aksione dhe të shlyer në kapital:

	\$	\$
Vlera kontabël e pagesës së bazuar në aksione	Nul	
Minus:		
Baza tatimore e pagesës së bazuar në aksione	(X)	
x norma e tatimit %	X	
Aktiv për tatimin e shtyrë		X

*Baza tatimore është lehtësimi tatimor i pritshëm i tatimeve në të ardhmen (bazuar në vlerën e brendshme të opsioneve) që është konstatuar deri në datën e raportimit.

Kur shuma e zbritjes tatimore të vlerësuar në të ardhmen tejkalon shpenzimin e akumuluar të shpërblimit, kjo tregon që zbritja tatimore lidhet pjesërisht me shpenzimet e shpërblimit dhe pjesërisht me kapitalin e vet. Prandaj, tatimi i shtyrë duhet të njihet pjesërisht në fitim ose humbje dhe pjesërisht në kapital.

Testoni njohuritë tuaja 5 - Splash

Një entitet, Splash, krijoi një skemë opsionesh të aksioneve për katër drejtorët e saj. Kjo skemë filloi më 1 korrik 20X8. Çdo drejtor do të kishte të drejtën e 25,000 opsione aksionesh me kusht që ata të qëndronin në Splash për katër vjet, nga data kur u prezantohet skema.

Informacioni në lidhje me opsionet e aksioneve jepet më poshtë:

Vlera e drejtë e opsionit në datën e dhënies 10 \$

Çmimi i ushtrimit të opsionit 5 \$

Vlera e drejtë e aksioneve më 30 qershor 20X9 ishte 17 \$ për aksion.

Zbritja tatimore jepet vetëm për opsionet e aksioneve kur ato ushtrohen. Zbritja e lejueshme do të bazohet në vlerën e brendshme të opsioneve. Supozoni një normë tatimore prej 30%.

Kërkohe:

Llogarisni dhe shpjegoni shumat që do të përfshihen në pasqyrat financiare të Splash për vitin e mbyllur më 30 qershor 20X9, përfshirë shpjegimin dhe llogaritjen e çdo implikimi të tatimit të shtyrë.

Humbjet tatimore të papërdorura

Kur një entitet ka humbje tatimore të papërdorura, SNK 12 lejon që një aktiv tatimor i shtyrë të njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimet e tatueshme në të ardhmen të jenë të disponueshme kundrejt të cilave humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren.

SNK 12 këshillon që aktivi tatimor i shtyrë duhet të njihet vetëm pasi të jetë marrë në konsideratë:

- nëse një entitet ka diferenca të përkohshme tatimore të mjaftueshme ndaj të cilave humbjet tatimore të papërdorura mund të kompensohen.
- nëse është e mundur entiteti do të realizojë fitime të tatueshme përpara se humbjet tatimore të skadojnë.
- nëse shkaku i humbjeve tatimore mund të identifikohet dhe nëse ka të ngjarë të përsëritet (përndryshe, ekzistenca e humbjeve tatimore të papërdorura është dëshmi e fortë që fitimet e tatueshme në të ardhmen mund të mos jenë të disponueshme).
- nëse mundësitë e planifikimit tatimor janë të disponueshme.

Testoni njohuritë tuaja 6 - Red

Më 31 Dhjetor 20X1, Red ka humbje të rregulluara nga tatimet prej 4 milion \$, të cilat vijnë nga një **ushtrim i ristrukturimit të njëhershëm**. Sipas legjislacionit tatimor, këto humbje mund të mbarten për të

lehtësuar fitimet e tatueshme në të ardhmen. Red ka parashikuar që fitimet totale të tatueshme për tre vitet në vijim do të jenë 2.5 mln \$. Megjithatë kontabilisti i Red nuk është në gjendje të parashikojë në mënyrë të besueshme fitimet pas kësaj date.

Norma e tatimit për fitimet e realizuara gjatë vitit që përfundoi më 31 Dhjetor 20X1 ishte 30%. Sidoqoftë, qeveria miratoi legjislacionin gjatë periudhës së raportimit, që uli normën e tatimit në 28% nga 1 janari 20X2.

Kërkohet:

Shpjegoni implikimet e tatimit të shtyrë për sa më sipër.

6. Kombinimet e biznesit dhe tatimi i shtyrë

Kontabiliteti për një kombinim biznesi, siç është konsolidimi i një filiali, mund të ketë disa implikime të tatimit të shtyrë.

Rregullimet e vlerës së drejtë

Aktivet dhe detyrimet e identifikueshme të filialit të blerë janë konsoliduar me vlerën e drejtë, por baza tatimore rrjedh nga vlerat në pasqyrat financiare të filialit individual. Kështu krijohet një diferencë e përkohshme, që sjell lindjen e tatimit të shtyrë në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Tatimi i shtyrë i njohur për këtë diferencë trajtohet si pjesë e aktiveve neto të blera dhe, si rezultat, ndikon në shumën e emrit të mirë të njohur në blerjen e filialit.

Vetë emri i mirë nuk krijon tatim të shtyrë sepse SNK 12 e përjashton atë në mënyrë specifike.

Testoni njohuritë tuaja 7 - Tom

Më 30 qershor 20X1 Tom fitoi 100% të aksioneve të Jones për 300,000 \$. Në këtë datë, vlera kontabël e aktiveve neto të Jones ishte 250,000 \$. I përfshirë në këtë vlerë të aktiveve neto është edhe inventari i cili kushton 50,000 \$, por kishte një kosto zëvendësimi prej 55,000 \$. Norma e zbatueshme e tatimit është 30%.

Kërkohet:

Shpjegoni implikimet e tatimit të shtyrë për sa më sipër në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit Tom.

Provizionet për fitime të porealizuara

Kur një kompani brenda një grupi shet inventar në një kompani tjetër të grupit, fitimet e porealizuara që mbeten brenda grupit në datën e raportimit duhet të eliminohen. Rregullimi i mëposhtëm kërkohet të bëhet në pasqyrat financiare të konsoliduara:

Debi: Kostoja e shitjeve (PASH)

Kredi: Inventari (Pasqyra e pozicionit financiar)

Ky rregullim zvogëlon vlerën kontabël të inventarit në pasqyrat financiare të konsoliduara, por baza tatimore e inventarit mbetet si kosto e tij në pasqyrat financiare individuale të kompanisë blerëse.

Kjo krijon një **diferencë të përkohshme të zbritshme**, duke sjellë lindjen e një **aktivi tatimor të shtyrë** në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Shënim: mund ta keni më të lehtë të mendoni për këtë rregullim në terma fitimesh. Fitimi i porealizuar në transaksionin brenda grupit hiqet nga pasqyrat financiare të konsoliduara dhe prandaj duhet të hiqet edhe ngarkimi i tatimit në këtë fitim.

Testoni njohuritë tuaja 8 – Mug

Mug zotëron 80% të aksioneve të zakonshme të Glass prej shumë vitesh. Gjatë këtij viti, Mug shiti inventarin e Glass për 250,000 \$, duke marrë një marzh fitimi bruto prej 40%. Një e katërta e këtij inventari mbetet e pashitur nga Glass në datën e raportimit.

Norma e tatimit është 20%.

Kërkohet:

Diskutoni për implikimet e tatimit të shtyrë për transaksionin e mësipërm.

Fitimet e papranuara/vazhdueshëm

Një diferencë e përkohshme lind kur vlera kontabël e investimeve në filialet, pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta është e ndryshme nga baza tatimore.

- Vlera kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara është pjesa e investitorit në aktivet neto të investuarit plus emri i mirë i blerë. Baza tatimore është zakonisht kostoja e investimit. Diferenca është fitimi i **papranuar/vazhdueshëm** (d.m.th. fitimi i pashpërndarë) i filialit, pjesëmarrësit ose sipërmarrjes së përbashkët.
- SNK 12 thotë se tatimi i shtyrë duhet të njihet me këtë diferencë të përkohshme, përveçse kur:
 - investitori kontrollon kohën e anulimit të diferencës së përkohshme dhe
 - ka mundësi që fitimet të mos shpërndahen në të ardhmen e parashikuar.

- Një investitor mund të kontrollojë politikën e dividendit të një filiali, por jo gjithmonë atë të llojeve të tjera të investimeve. Kjo do të thotë që tatimi i shtyrë nuk lind për investime në filiale, por mund të lindë nga investimet në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta.

Aktivitet financiar mund të sjellin lindjen e një tatimi të shtyrë nëse rivlerësohen.

7. Dhënia e shënimeve shpjeguese

Një entitet duhet të japë shënime shpjeguese për:

- përbërësit kryesorë të shpenzimit tatimor
- tatimin e njohur drejtpërdrejtë në kapital
- tatimin e lidhur me zërat e njohur drejtpërdrejtë në kapital
- tatimin e lidhur me secilin përbërës të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
- një shpjegim të marrëdhënies midis shpenzimit tatimor dhe fitimit kontabël.

Testoni njohuritë tuaja 9 – HCRM

Në vitin që mbyllet më 31 dhjetor 20X1, HCRM regjistroi një fitim përpara tatimeve prej 300 \$. Norma e tatimore e tij është 20%.

Në përputhje me SNK *Tatimi mbi të ardhurat*, ajo ka dhënë shënimet e mëposhtme shpjeguese në pasqyrat financiare të publikuara:

	Mln \$
Fitimi përpara tatimit	300.0
Fitimi para tatimit i shumëzuar më normën tatimore 20%	60.0
Rregullimet në tatimin aktual në lidhje me vitet e mëparshme	8.2
Zhvlerësimi i aktiveve që nuk klasifikohen për lehtësim tatimor	(1.5)
Sundry disallowables (moslejesat e ndryshme)	(0.7)
Ngarkimi tatimor total	<u>66.0</u>
Norma efektive tatimore (%)	22

Kërkohe:

Diskutoni pse dhënia e shënimeve shpjeguese siguron informacion të dobishëm për investitorët e HCRM.

Përmbledhje e kapitullit 8

